

## PARLAMENTI II RURAL SHQIPTAR 2020|PERSPEKTIVA EUROPIANE E SHQIPËRISË RURALE

*Parlamenti Rural Shqiptar (PRSH) është nismë e Rrjetit Shqiptar të Zhvillimit Rural (ANRD) dhe përfaqëson një platformë advokacie, ndërtimi të kapaciteteve dhe rjetëzimit dedikuar zhvillimit rural. Parlamenti Rural Shqiptar është pjesë e lëvizjes mbarë europiane rurale që synon mirëqenie të banorëve të zonave rurale (<https://anrd.al/parlamenti-rural-shqiptar-2/>)*

Platforma e Parlamentit Rural Shqiptar është një praktikë gjithëpërfshirëse që synon të influencojë dhe përshpejtojë proceset reformuese në sektorin rural për revitalizimin e komuniteteve rurale. Në vijim të Parlamentit I Rural Shqiptar (shtator 2017) dhe, në përgjigje të sfidave aktuale të zhvillimit bujqësorë dhe rural, **ANRD në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT) organizojnë Parlamentin II Rural Shqiptar, 2-3 Prill 2020.**



Parlamenti i këtij viti do të konfirmoj përpjekjet e ANRD për ta kthyer platformën e parlamentit rural në një kuadër rregullator kombëtar për zhvillimin rural dhe bujqësor me synimin për të nxitur dhe mbajtur të qëndrueshëm dialogun kombëtar mbi qeverisjen e sektorit.

Parlamenti II Rural Shqiptar – një platformë e decentralizuar - do të organizohet në vijim të katër forumeve rurale rajonale për të përmbyllur përpjekjet advokuese të aktorëve të interesit në të gjitha nivelet.

- Forumi rural rajonal i Drinit
- Forumi rural rajonal i Arbërit
- Forumi rural rajonal i Egnatias
- Forumi rural rajonal i Vjosës

**PARLAMENTI II RURAL SHQIPTAR 2-3 Prill 2020, Tiranë**

### STRATEGJIA E RE NDËRSEKTORIALE E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL – një pikë kthese në hartimin me pjesëmarrje të strategjive rurale

Hartimi i strategjisë së re të sektorit në mënyrë të natyrshme duhet të nisë me konsultimin e grupeve të interesit për t'iu përgjigjur nevojave reale dhe interesave të tyre, ndërsa zbatimi i saj ka nevojë për bashkëpronësinë e banorëve të zonave rurale si grupi të cilit i shërben. Pavarësisht përpjekjeve të bëra në përfshirjen e grupeve të interesit në procesin e formulimit të strategjive dhe programeve të zhvillimit bujqësor dhe rural, ka nevojë për të lëvizur në shkallë më të larta të pjesëmarrjes qytetare të tilla si konsultimi, dialogu dhe partneriteti. Gjithashtu, ka nevojë për të përfshirë gjithnjë e më shumë aktorë të ndryshëm, jo vetëm grupe të organizuara, po edhe grupe, nisma, individë me leadership të fortë në komunitete vendore që nuk janë të lidhur me proceset e politikëbërjes.

Parlamenti rural shqiptar synon të sjellë më afër fermerët, banorët e zonave rurale, të rinjtë dhe gratë rurale, grupet e prodhuesve, akademinë, OSHC-të dhe të tjerë aktorë të interesit me politikëbërësit për t'iu konsultuar dhe njohur me nevojat, interesat dhe prioritetet e tyre. Ky input duhet të merret në konsideratë përgjatë procesit të hartimit të strategjisë së re ndër-sektoriale të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

### SKEMAT KOMËTARE TË MBËSHTETJES SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL – ndërtimi i partneritetit dhe besimit ndërmjet fermerëve dhe qeverisjes së sektorit

Ky komponent mbështet domosdoshmërinë jetike për dialog kombëtar të vazhdueshëm mbi qeverisjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural, një dialog që synon të ndërgjegjësojë dhe diskutojë mbi sfidat dhe barrierat që pengojnë politikën dhe instrumentet mbështetëse të sektorit për të qenë efektive ndaj problemeve dhe nevojave reale si dhe për të gjetur zgjidhje të mundshme dhe të qëndrueshme.

Mbështetja buxhetore për bujqësinë dhe zhvillimin rural është shumë e ulët dhe jo proporcionale me rëndësinë ekonomike dhe demografike si dhe me nevojat reale të sektorit. Për më tepër, kjo mbështetje rezulton të jetë ndjeshëm nga më të ulëtat krahasuar me të gjithë vendet e rajonit. Advokacia e PRSH II lidhet me rritjen e mbështetjes buxhetore kombëtare për bujqësinë dhe zhvillimin rural për ta bërë funksional partneritetin ndërmjet qeverisjes së sektorit dhe fermerëve shqiptarë si dhe popullatës rurale. Përafrimi i mbështetjes buxhetore për bujqësinë dhe zhvillimin rural me vendet e rajonit do të jetë edhe deviza e advokacisë së këtij parlamenti.

### **LËVIZJA RINORE RURALE - Realiteti i të rinjve në zonat rurale ndërmjet sfidave dhe aspiratave për të ardhmen**

Pavarësisht rolit dhe kontributit të rëndësishëm të të rinjve në qëndrueshmërinë e jetës shoqërore në zonat rurale, bujqësisë si dhe sigurisë ushqimore, migrimi i tyre është një nga sfidat më të mëdha dhe risku kryesor i qëndrueshmërisë për të gjithë sektorin. Ndërkohë, politikat publike kanë qenë joefektive për të adresuar çështjet në lidhje me përfshirjen e të rinjve në bujqësi, si dhe me trendin gjithnjë në rritje të migrimit të tyre.

Tashmë është koha për të kërkuar politika që pasqyrojnë nevojat dhe përparësitë reale të rinisë rurale, dhe që orientohen nga aspiratat e të rinjve për të ardhmen rurale. Për ta bërë këtë, duhet formuluar një qëndrim rrënjësor i ri ndaj realitetit rural - ta shohim botën rurale nga perspektiva e rinisë. Parlamenti rural do të përpiqet të kuptojë dhe shpjegojë situatën aktuale të rinisë rurale (nevojat dhe përparësitë) si dhe aspiratat dhe ëndrrat e tyre (vizionin për të ardhshmen) për komunitetet rurale.

### **JETESIMI I QASJES LEADER NË KOMUNITET RURALE SHQIPTARË – aktivizimi dhe mbështetja e lidërshiptit vendor**

Zhvillimi rural sipas politikave evropiane - si një qasje ndër-sektoriale që përfshin një spektër të gjerë aktorësh – përfaqëson një paradigmë të re të zhvillimit rural me pjesëmarrje që mundësohet përmes zbatimit të qasjes Leader. Megjithatë, zbatimi i qasjes në Shqipëri ka vështirësi dhe sfida që lidhen kryesisht me nivelin e ulët të kapitalit social, mungesën e theksuar të kapaciteteve të qeverisjes vendore, organizatave të shoqërisë civile dhe biznesit për të hyrë në partneritete afatgjata që përputhen me parimet e qasjes LEADER.

Qasja LEADER vendos njerëzit në qendër të zhvillimit vendor nëpërmjet Grupeve Lokale të Veprimit (GLV-të) dhe si e tillë mbështetet dhe kërkon lidërshipt dhe pronësi vendore. Në vijim të advokacisë dhe ndërtimit të kapaciteteve për qasjen LEADER në Parlamentin e Parë, rinis debati në lidhje me një sipërmarrje kombëtare për zbatimin e saj. Nismëtarët në nivel vendor duhet të mbështeten për një zbatim të suksesshëm të qasjes LEADER në Shqipëri. Në këtë drejtim kërkohen përpjekje proaktive nga MBZHR për të përafruar politikën evropiane të zhvillimit rural – zhvillimi vendor i udhëhequr nga komuniteti – me dinamikën vendore dhe nevojat e qytetarëve.